

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Shkathtësi Akademike dhe Komunikim në Biznes
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	I
Semestri:	I
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë synon t'u ofrojë studentëve njohuri teorike dhe aftësi praktike në fushën e shkrimit akademik, komunikimit efektiv dhe prezantimit profesional. Programi fokusohet në zhvillimin e kompetencave për të shkruar, lexuar dhe analizuar në mënyrë kritike punime akademike dhe materiale të tjera profesionale, duke përfshirë edhe shkrimet e vetë studentëve. Përmes një kombinimi të ligjëratave teorike dhe ushtrimeve praktike, lënda trajton temat: shkrimi dhe leximi kritik; shkrimi akademik; drejtshkrimi dhe drejtshqiptimi; kuptimi dhe rëndësia e komunikimit; kodet e komunikimit dhe kuptimi i tyre; parimet e komunikimit efektiv. Një pjesë e rëndësishme i kushtohet procesit të punimit kërkimor nga zgjedhja e temës dhe përzgjedhja e literaturës, te shfrytëzimi i burimeve dhe hartimi i punimit. Struktura e punimit kërkimor (seminar, diplomë, magjistraturë, doktoratë) shtjellohet në detaje duke përfshirë hyrjen, ndarjen në kapituj, përfundimin, burimet dhe literaturën. Studentët njihen me format dhe mënyrat e citimit, përdorimin e fusnotave (llojet, formatet) si dhe me proceset e lekturës, korrekturës dhe redaktimit të tekstit. Një fokus i veçantë i kushtohet komunikimit në publik, me qëllim zhvillimin e aftësive prezantuese dhe të oratorisë. Lënda inkurajon publikimin e shkrimeve profesionale të studentëve, duke kontribuar në përmbushjen e kërkesave themelore akademike dhe rritjen e prezencës së tyre në diskursin profesional dhe shkencor.
Qëllimet e lëndës:	Objektivi kryesor i kësaj lënde është zhvillimi i aftësive akademike dhe të komunikimit tek studentët, duke i pajisur ata me njohuritë, teknikat dhe mjetet e nevojshme për të shkruar, analizuar dhe prezantuar në mënyrë efektive në kontekste akademike dhe profesionale. Lënda synon të: • Ndërtojë aftësi për shkrim dhe lexim kritik, me fokus në standardet e shkrimit akademik. • Rrisë kompetencat në drejtshkrim, drejtshqiptim dhe përdorim korrekt të gjuhës në komunikimin e shkruar dhe verbal. • Pajisë studentët me aftësi për të strukturuar dhe realizuar punime kërkimore në përputhje me kërkesat akademike. • Njohë studentët me parimet e komunikimit efektiv dhe përdorimin e kodeve të komunikimit në situata profesionale.

	Forcojë aftësitë prezantuese dhe oratorinë për komunikim publik dhe prezantim të punimeve akademike.		
Rezultatet e pritura të mësim-nxënies:	<i>Pas përfundimit të ligjëratave pritët që studentët të:</i> 1. Shpjegojnë konceptet themelore të shkrimit akademik, leximit kritik dhe parimet e komunikimit efektiv në kontekst akademik dhe profesional. ECTS: 1 2. Zbatojnë teknikat e shkrimit akademik dhe të leximit kritik për hartimin e punimeve kërkimore me përmbajtje të argumentuar dhe të strukturuar mirë. ECTS: 1 3. Përdorin në mënyrë korrekte drejtshkrimin, drejtshqiptimin dhe kodet e komunikimit në komunikimin e shkruar dhe verbal. ECTS: 1 4. Organizojnë dhe strukturojnë punime kërkimore sipas standardeve akademike, duke përfshirë citimin, fusnotat dhe referencat bibliografike. ECTS: 1 5. Zbatojnë proceset e lekturës, korrekturës dhe redaktimit për përmirësimin e cilësisë së tekstit dhe përgatitjen për publikim. ECTS: 1 6. Komunikojnë në publik në mënyrë të qartë, bindëse dhe profesionale, duke përdorur teknika prezantimi dhe publikimi të punimeve akademike dhe profesionale. ECTS: 1		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit - konsultimet	1	10	10
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi - Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			40
Përgatitja përfundimtare në provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	3	6
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies:	Ky kurs zhvillohet përgjatë një semestri prej 15 javësh, përmes sesioneve të rregullta javore që përfshijnë 3 orë ligjërata dhe/ose ushtrime. Mësimdhënia është konceptuar në mënyrë të integruar, duke kombinuar përvetësimin e njohurive teorike me zbatimin praktik të tyre, me qëllim arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit. Procesi mësimor bazohet në një qasje të kombinuar dhe interaktive, e cila përfshin: Ligjërata të strukturuar me përdorimin e mjeteve bashkëkohore audio-vizuale (PowerPoint, videomateriale, platforma digjitale)		

	të orientuara drejt prezantimit të koncepteve kyçe dhe shembujve praktikë nga fusha e komunikimit dhe shkrimit akademik. • Ushtrime individuale dhe grupore, të fokusuara në hartimin, shqyrtimin dhe diskutimin e punimeve shkencore dhe profesionale të studentëve, si dhe në zhvillimin e aftësive të komunikimit të shkruar dhe verbal. • Diskutime të strukturuar, debate dhe analiza rreth temave të trajtuara, me qëllim stimulimin e të menduarit kritik, reflektimit dhe shkëmbimit të përvojave. • Shkrim dhe interpretim të teksteve akademike dhe profesionale, duke respektuar normat e drejtshkrimit, drejtshqiptimit dhe strukturës akademike. • Verifikim të njohurive përmes testimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm, duke përfshirë ese, punime seminarike dhe prezantime të strukturuar. • Përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe platformave digjitale për përpunimin, redaktimin dhe publikimin e materialeve, si dhe për simulimin e situatave reale të komunikimit profesional. Pjesëmarrja aktive e studentëve konsiderohet thelbësore për suksesin e procesit mësimor. Studentët inkurajohen të ndjekin rregullisht të gjitha sesionet dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në diskutime, ushtrime dhe punë praktike, duke zhvilluar kompetenca që i përgatisin për kërkesat akademike dhe profesionale të mjedisit bashkëkohor.
--	--

Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë:

Metoda e vlerësimit – mbështetet ne tri aktivitete – ne baze të të cilave do te ndërtohet nota përfundimtare:

- Aktivitet dhe Angazhim në mësim.....**max 20 pikë (%)**,
- Hartimi i projektit/punim seminari.....**max 10 pikë (%)**,
- Provimi final (ose nga dy teste).....**max 70 pikë (%)**,

Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit:

1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme:

- Aktiviteti në mësim (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti te jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema te reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim te nxitjes se debatit gjatë ligjëratave.
- Angazhimi (**10 pikë (%)**) - nënkupton që studenti ti kryej dhe prezantoj detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese.

Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien ne modulën e lëndës.

2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminari - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo me shume se 3 studentë) duhet të përgatit një projekt/punim seminari (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti 15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet te miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë ne korrelacion te plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit te projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	3
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	4
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	3
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien ne modulën e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

	Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuar nga senati i Universitetit. Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban: ➤ Pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të ri- kujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....30 pikë (%), ➤ Pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jete në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....40 pikë (%) Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike. Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit, Notat në UShAF: <table><tr><th>Nota</th><th>ECTS/Nota</th><th>Përqindja (%)</th><th>Përkufizimi</th></tr><tr><td>10</td><td>A</td><td>90 - 100</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>9</td><td>B</td><td>80 - 89</td><td>Shkëlqyeshëm</td></tr><tr><td>8</td><td>C</td><td>70 - 79</td><td>Shumë mirë</td></tr><tr><td>7</td><td>D</td><td>60 - 69</td><td>Mirë</td></tr><tr><td>6</td><td>E</td><td>50 - 59</td><td>Mjaftueshëm</td></tr><tr><td>5</td><td>FX/F</td><td>0 - 49</td><td>Pamjaftueshëm</td></tr></table>	Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi	10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm	9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm	8	C	70 - 79	Shumë mirë	7	D	60 - 69	Mirë	6	E	50 - 59	Mjaftueshëm	5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi																										
10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm																										
9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm																										
8	C	70 - 79	Shumë mirë																										
7	D	60 - 69	Mirë																										
6	E	50 - 59	Mjaftueshëm																										
5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm																										
Mjetet e konkretizimit - TI	Përdorimi Tabela inteligjente, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.																												
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit:	Struktura e këtij moduli është projektuar për të krijuar një ekuilibër të qëndrueshëm ndërmjet komponentës teorike dhe asaj praktike, duke synuar që studentët të ndërtojnë fillimisht një bazë të fortë konceptuale dhe më pas ta zbatojnë atë në situata reale të komunikimit akademik dhe profesional. Në këtë kuadër, moduli është i ndarë sipas raportit: • 70% teori dhe • 30% ushtrime/ detyra praktike, si më poshtë: 105 orë i dedikohen ligjëratave teorike, ku studentët pajisen me njohuri mbi konceptet themelore të shkrimit dhe komunikimit																												

	akademik, parimet e komunikimit efektiv, drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin, analizën kritike të teksteve, si dhe metodologjitë e hartimit të punimeve kërkimore. 45 orë i dedikohen aktiviteteve praktike, që përfshijnë: ✓ Ushtrime në klasë mbi shkrimin dhe analizimin e teksteve. ✓ Diskutime dhe debate rreth temave të trajtuara. ✓ Punë individuale dhe në grup për hartimin e eseve, punimeve seminarike dhe prezantimeve. ✓ Analiza dhe redaktim i punimeve të studentëve. Në përputhje me këtë strukturë orësh, edhe shpërndarja e 6 ECTS bëhet proporcionalisht: ➤ 4 ECTS i dedikohen përmbajtjes teorike, me fokus në ndërtimin e njohurive akademike dhe zhvillimin e kompetencave të shkrimit dhe komunikimit profesional. ➤ 2 ECTS i dedikohen përmbajtjes praktike, duke u orientuar drejt zhvillimit të aftësive analitike, praktike, kritike dhe prezantuese. Kjo ndarje pasqyron një qasje bashkëkohore që integron mësimin teorik me aplikimin praktik, duke përgatitur studentët për të përballuar sfidat akademike dhe profesionale në fushën e komunikimit dhe biznesit.
Literatura	
Literatura bazë	1. Bovee, Courtland, Thill, John, 2021, „Business Communication Today”, Global Edition, Pearson 2. Gjovalin Shkurtaç, „Si të shkruajmë shqip”, Morava, Tiranë, 2013.
Literatura shtesë	1. Andri Koxhaj, Florian Tomini, “Manaxhimi i komunikimit”, Tiranë, 2006. 2. S. I. Hayakawa, „Language in Thought and Action”, 1949 3. Rami Memushaj, „Shqipja standard”, Toena, Tiranë, 2004. 4. Sylvian Barnet, Pat Bellanca, Marica Stubbs, „Shkrimi akademik”, Dita, Tiranë, 2000.
<u>Informacion shtesë</u> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	*A. Loku & N. Loku; Paper; „<i>The correlation between quality change management and process implementation with financial and non-financial market performance in south-eastern Europe companies</i>”, 2023 Journal: Asian Economic and Financial Review - Vol. 13, No. 8, 533-546. Link: https://archive.aessweb.com/index.php/5002/article/view/4816/7636
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Njohja me përshkrimin e lëndës, metodat, vlerësimin, burimet dhe literaturën. Rezultati i pritur nr. 1 & 2
Java e dytë	Nocionet themelore: gjuha; shkrimi; leximi kritik; shkrimi akademik; drejtshkrimi; drejtshqiptimi Rezultati i pritur nr. 1 & 3

Java e tretë	Kuptimi dhe rëndësia e komunikimit Rezultati i pritur nr. 2 & 3
Java e katërt	Kultura e komunikimit Rezultati i pritur nr. 2 & 4
Java e pestë	Kodet e komunikimit dhe kuptimi i tyre; parimet e komunikimit efektiv Rezultati i pritur nr. 2 & 4
Java e gjashtë	Zbatimi i Menaxhimit të cilësisë së përgjithshme si proces i ndryshimeve në një kompani Ndikimi i Inteligjencës Artificiale në cilësinë dhe avantazhet konkurrues, Tema nga punimi shkencor: „ <i>The correlation between quality change management and process implementation with financial and non-financial market performance in south-eastern Europe companies</i> ” Niveli i zbatimit të menaxhimit të cilësisë së përgjithshme Dimensionaliteti dhe vlefshmëria e instrumentit: Performanca operacionale dhe e tregut Rezultati i pritur nr. 1, 4 & 6
Java e shtatë	Struktura e punimit kërkimor (seminari, diploma, magjistratura, doktorata): hyrja; tema (ndarja në kapituj), përfundimi, burimet dhe literatura, Testi i parë, Rezultati i pritur nr. 3 & 5
Java e tetë	Vlerësimi i esesë, Vlerësimi i strukturës së punimit shkencor Rezultati i pritur nr. 3 & 5
Java e nëntë	Citimi (llojet, mënyrat, format); fusnota (llojet, format) Rezultati i pritur nr. 3 & 6
Java e dhjetë	Burimet dhe literatura (literatura bazë, literatura ndihmëse); bibliografia; aspektet teknike të punimit kërkimor Rezultati i pritur nr. 3 & 6
Java e njëmbëdhjetë	Shkrimi i një recensionit për një libër nga drejtimi përkatës Rezultati i pritur nr. 4 & 6
Java e dymbëdhjetë	Lektura, korrektura dhe redaktimi Rezultati i pritur nr. 4 & 6
Java e trembëdhjetë	Komunikimi në publik Rezultati i pritur nr. 4 & 6
Java e katërmbëdhjetë	Vlerësimi i esesë dhe recensionit Rezultati i pritur nr. 5 & 6
Java e pesëmbëdhjetë	Rekapitullimi i çështjeve kryesore të shkathtësive të komunikimit; Testi i dytë,

	Rezultati i pritur nr. të gjitha (1 - 6)
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimmshënësi ka të drejtë t'i kërkoj studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.	